

KOSOVA: ZGJEDHJE HISTORIKE

21 Nëntor 2001

TREGUESI I PËRMBAJTJES

I. HYRJE

II. STRUKTURAT E VETËQEVERISJES

- A. REZOLUTA 1244 E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA
- B. KORNIZA KUSHTETUESE
- C. INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES SË PËRKOQSHME
 - 1. Kuvendi
 - 2. Qeveria
 - 3. Presidenti

III. PARTITË SHQIPTARE TË KOSOVËS

- A. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK)
- B. PARTIA DEMOKRATIKE EKOSOVËS (PDK)
- C. ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK)
- D. KOMBINIME TË MUNDËSHME

IV. PJESËMARRJA E SERBËVE

- A. CËSHTJET E DISKUTUARA
- B. BEOGRADI DHE KOSOVA
- C. MARRËVESHJA
- D. SERBËT E KOSOVËS

V. PËRFUNDIME

SHTOJCA

- A. HARTA E KOSOVËS
- B. INTERNATIONAL CRISIS GROUP
- C. RAPORTE DHE UDHËZIME TË ICG
- D. ANËTARËT E BORDIT TË ICG

KOSOVA: ZGJEDHJE HISTORIKE

PËRMBLEDHJE DHE REKOMANDIME EKZEKUTIVE

Në 17 nëntor 2001, populli i Kosovës filloi një faqe të re në historinë e tij duke votuar për zgjedhjet shumëpartiake për institucionet e reja vetëqeverisëse. Mendimi i përgjithshëm për procesin zgjedhor ka qënë se ato shënuan një përparim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e tetorit 2000 për pushtetin vendor. Niveli i dhunës ka qënë më i ulët ndonëse numri i votuesve ka qënë më i lartë.

Po ashtu, si vitin e kaluar, shqiptarët votuan kryesisht për tri parti. Në ndryshim nga viti i kaluar, serbët morën pjesë në votime. Nëse këta të fundit do të kishin votuar në mënyrë masive, do të mund të kishin fituar 25 vende në Kuvendin e përbërë prej 125 vendesh. Përkundrazi, udhëzimet çorientuese të udhëheqësve të tyre – disa prej të cilëve propagandues të braktisjes së votimit – e ulën numrin e votuesve serbë.

Ndërtimi i institucioneve të reja vetëqeverisëse të Kosovës, të dala nga zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2001, do të përbëjë një moment kthese në zhvillimin e kësaj province pas konfliktit. Pushteti i institucioneve të reja do të jetë i kufizuar, dhe pavarësisht nga transferimi i përgjegjësive për zgjidhjen e çështjeve të përditëshme, pushteti vendimmarrës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) do të mbetet i pandryshuar.

Megjithatë, rëndësia politike e zgjedhjes së Kuvendit, pavarësisht nga kufizimet e pushtetit të tij, qëndron në legjitimitetin e tij për shumicën shqiptare të popullsisë. Ekzistenca e këtij Kuvendi të zgjedhur dhe e një Qeverie të Kosovës do ta ndryshojë në mënyrë vendimtare pamjen politike të provincës dhe marrëdhëniet e administratës së UN-it me udhëheqësit politikë vendorë.

Është tepër i rëndësishëm fakti që PSSP ka autoritet për të vepruar kundër çdo përpjekjeje për tejkalim të kompetencave institucionale, siç përcaktohet në Kornizën Kushtetuese, e cila parashikon pushtetin e organizmave të reja. Për më tepër, këto institucione nuk kanë autoritetin e nevojshëm për të vepruar në drejtim të përcaktimit të statusit final të Kosovës. Kjo është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (RKSOKB 1244).

Rrjedhimisht, çdo orvatje e partive shqiptare të Kosovës për ta përdorur Kuvendin për arritjen e pavarësisë, do të ishte e padobishme. Megjithatë, pavarësisht nga kufizimet, Kuvendi do të jetë një forum i ri dhe i rëndësishëm përmes të cilit udhëheqësit vendorë me legjitimitetin e një mandati demokratik do të kenë mundësi t'i bëjnë oponencë UNMIK-ut me mënyra të cilat janë ende të paqarta.

Në procesin parazgjedhor, një çështje thelbësore ishte pjesëmarrja ose jo e serbëve. PSSP ndërmori një sërë negociatash dinamike me udhëheqësit e Beogradit, çka dha rezultate vetëm dy javë para votimit. Ndërkohë që një marrëveshje i mundësoi Beogradit pohimin e arritjes të disa prej kërkesave të tyre, por pa shkëljen e parimeve të RKSOKB 1244 apo të Kornizës Kushtetuese nga ana e UNMIK-ut. Udhëheqësit shqiptarë u shqetësuan nga kjo marrëveshje dhe nga përfshirja e Beogradit në këtë proces.

Ndërkohë, një numër i madh serbësh në disa pjesë të Kosovës qëndruan larg nga votimet. Kërcinimi ndaj serbëve me të drejtë vote, çka dëmtoi zgjedhjet në pjesën e kontrolluar nga serbët në veri të lumit Ibër, e bëri të qartë nevojën për ndërhyrjen e UNMIK-ut dhe të KFOR-it për eliminimin e kriminalitetit, që i përkrahur nga Beogradi pengon shtrirjen e autoritetit të UNMIK-ut në atë zonë.

Zyrtarët perëndimorë u kanë kërkuar me ngulm udhëheqësve vendorë kosovarë, ta braktisin për momentin çështjen e pavarësisë dhe të përqëndrohen në funksionimin e institucioneve të reja, duke dhënë kështu prova për aftësitë e tyre për qeverisjen e provincës. Në të vërtetë, marrja e përgjegjësive qeverisëse do të ishte një sfidë për udhëheqësit kosovarë, të cilët kanë më tepër përvojë në kundërshtimin e institucioneve sesa në themelimin e tyre.

Por nuk do të ishte reale të shpresohet se udhëheqësit shqiptarë të Kosovës apo votuesit do ta braktisin atë çështje që për ta është thelbësore. Nëse Kuvendi përpiqet ta shtrijë rolin e tij përtej asaj çka është përcaktuar në Kornizën Kushtetuese apo vepron në mënyrë konfrontuese, PSSP mund të marrë masa të rrepta. Megjithatë, zyrtarët e sapo zgjedhur ka pak mundësi t'i pranojnë për një kohë të gjatë kufizimet e administratës ndërkombëtare të pazgjedhur. Inati i shqiptarëve në lidhje me marrëveshjen e UNMIK-ut me Beogradin për të arritur përkrahjen për pjesëmarrjen e serbëve, së bashku me padurimin e shkaktuar nga përparimi i ngadaltë drejt pavarësisë, mund të jenë nxitës për marrëdhënie të tendosura mes UNMIK-ut dhe partive shqiptare pas zgjedhjeve .

REKOMANDIME

PËR BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE

1. UNMIK-u duhet t'u lejojë institucioneve të reja vetëqeverisëse sa më tepër liri për qeverisje brenda parametrave të përcaktuara në Kornizën Kushtetuese. Këtyre institucioneve duhet t'u jepet mundësia të mësojnë nga gabimet për të rritur përgjegjësinë dhe efektivitetin.

2. Krijimi i autonomisë të kufizuar përmes institucioneve vetëqeverisëse duhet të shihet si mënyra e vetme për fillimin e një procesi që më pas do transferojë më tepër pushtet “të mirëfilltë” vetëqeverisës tek institucionet e zgjedhura të Kosovës, në nivelin provincial dhe atë komunal.
3. Për të shmangur acarime të panevojshme me shumicën e Kosovarëve, UNMIK-u në përfaqësimin e interesave të jashtme të Kosovës, duhet të këshillohet me përfaqësuesit e zgjedhur vendorë dhe t’i marrë parasysh seriozisht pikëpamjet tyre.
4. KFOR-i duhet të vazhdojë të ndërmarrë hapa dhe më efektive për mbrojtjen e qytetarëve serbë dhe romë, përfshi goditjen ndaj forcave të paligjshme paramilitare dhe të sigurimit të serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës.
5. Bashkësia ndërkombëtare duhet të marrë nën kontroll situatën në Mitrovicë. KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut duhet të veprojnë, nëse është e nevojshme dhe me forcë ligjore, kundër “rojeve të urës”, dhe autoriteti i UNMIK-ut me përkrahjen e KFOR-it duhet të shtrihet në veri të lumit Ibër.

PËR SHQIPTARËT E KOSOVËS

6. Përfaqësuesit e sapozgjedhur duhet të përqëndrohen në funksionimin e institucioneve të reja vetëqeverisëse, më tepër se sa në veprimet e papjekura në lidhje me statusin përfundimtar të Kosovës.
7. Këta përfaqësues të zgjedhur duhet të ndërmarrin krijimin e një komisioni, ndoshta brenda Kuvendit të ri, për të shqyrtuar mundësi konstruktive në lidhje me marrëdhëniet e Kosovës me Beogradin, dhe për të përgatitur propozime që do të përbënin bazën e diskutimeve me Beogradin dhe bashkësinë ndërkombëtare.
8. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës duhet të ushtrojnë autoritetin e tyre moral për marrjen e përgjegjësisë për përmirësimin e kushteve të serbëve dhe të romëve në Kosovë, pakësimin e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj tyre dhe mundësimin e kthimit të refugjatëve.

PËR SERBËT E KOSOVËS

9. Përfaqësuesit e sapozgjedhur serbë duhet ta përfaqësojnë bashkësinë e tyre përmes pjesëmarrjes konstruktive në institucionet e reja vetëqeverisëse të Kosovës dhe të bashkëpunojnë me UNMIK-un.
10. Udhëheqësit serbë të Kosovës duhet të bashkëpunojnë me UNMIK-u dhe KFOR-in për bashkimin e rajonit në veri të Ibrit me kornizën institucionale të Kosovës dhe për t’u mundësuar shqiptarëve të zhvendosur kthimin e sigurt në shtëpitë e tyre.

PËR BEOGRADIN

11. Beogradi duhet të bashkëpunojë me UNMIK-un dhe duhet t’i japë fund përkrahjes për serbët e Kosovës që pengojnë bashkimin e zonës në veri të Ibrit me Kosovën.
12. Beogradi duhet t’i nxisë përfaqësuesit serbë të Kosovës të marrin pjesë konstruktive në institucionet e reja të Kosovës.

Prishtinë/Bruksel, 21 nëntor 2001

KOSOVA: ZGJEDHJE HISTORIKE

I. HYRJE

Zgjedhjet e 17 nëntorit për Kuvendin e ri të Kosovës, përbëjnë një moment të rëndësishëm kthese për historinë e provincës. Formati i Kuvendit dhe përgjegjësitë e tij u përcaktuan nga Korniza Kushtetuese e nënshkruar në maj 2001 nga përfaqësuesit e Kosovës dhe zyrtarët e UNMIKU-t.

Korniza Kushtetuese përcakton fushat e kompetencës për qeverinë e re të formuar pas zgjedhjeve. Asnjë bashkësi apo parti politike nuk është tërësisht e kënaqur me këtë dokument. Përgjithësisht, udhëheqësit shqiptarë do të kishin parapëlqyer të shihnin pushtet më të madh për institucionet e reja, duke parë tek zgjedhjet një hap drejt qëllimit përfundimtar - pavarësisë. Në të kundërt, udhëheqësit serbë, për të cilët synimi i mësipërm është për ta pasur frikë dhe për ta kundërshtuar, dëshironin ta zbehnin rëndësinë historike të institucioneve të reja.

Në përputhje me RKSOKB 1244, e cila është në themel të sistemit të aktual të përkohshëm¹, Korniza Kushtetuese nuk parashikon çështjen e statusit përfundimtar të Kosovës, dhe institucionet e themeluara në bazë të saj nuk do të kenë kompetencë të ndërmarrin hapa për përcaktimin e kësaj çështjeje. Kështu, në dritën e këtyre fakteve, shpresa dhe frika e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës ballë Kuvendit të ri, duken të pabazuara. Formalisht, mbajtja e zgjedhjeve dhe krijimi i institucioneve vetëqeverisëse vetëm zbaton masat e RKSOKB 1244, dhe rrjedhimisht, Kosova as nuk i afrohet pavarësisë e as i largohet asaj. Megjithatë, një analizë e tillë e situatës do ta shuante domethënien politike të krijimit të Kuvendit të dalë nga zgjedhjet dhe legjitimitetit që ai do të ketë për shumicën shqiptare të popullsisë, pavarësisht nga kufizimet e autoritetit të tij.

Për shkak të situatës të pasigurt për popullatën joshqiptare të Kosovës (veçanërisht serbe dhe rome) dhe të kufizimeve në lëvizjen e tyre si pasojë e kësaj, zgjedhjet nuk mund të cilësohen brenda standartit të zakonshëm për ndërkombëtarët si “të lira dhe të ndershme”. Më saktë, OSBE-ja ka synuar për standartin më të ulët si “legjitime dhe të besueshme”.²

Në procesin parazgjedhor, një nga çështjet më të rëndësishme ishte pjesëmarrja ose jo në zgjedhje e serbëve të Kosovës. Ndërkohë që Beogradi u bëri thirrje serbëve të votojnë vetëm dy javë para zgjedhjeve, shumë serbë të Kosovës e kundërshtuan këtë vendim dhe zgjedhjet u dëmtuan nga kërcënimi ndaj serbëve në disa zona për të mos votuar. Por megjithatë, mbajtja e zgjedhjeve edhe në kushte të tilla përbën një hap të rëndësishëm në plotësimin e mandatit të UNMIK-ut bazuar në RKSOKB 1244, për më tepër duke pasur parasysh dyshimet e mëparshme nëse do të mund të mbaheshin zgjedhje në vitin 2001.

Ky raport trajton rëndësinë e këtyre zgjedhjeve dhe të krijimit të institucioneve të reja vetëqeverisëse për Kosovën. Ai shqyrton se si këto zgjedhje do të ndryshojnë marrëdhëniet mes faktorëve politikë vendorë dhe administratës së UNMIK-ut. Ai shqyrton çështjen e pjesëmarrjes së serbëve të Kosovës në zgjedhje, dhe atë se çfarë do të thotë kjo për pozicionin e serbëve në Kosovë. Po kështu, ai trajton sfidat që udhëheqësit vendorë dhe UNMIK-u do të përballin në vënien në funksionim të institucioneve dhe në hapat e ndërmarrja në vazhdimësinë e paraparë nga RKSOKB 1244 drejt statusit përfundimtar të Kosovës.

II. STRUKTURAT E VETËQEVERISJES

A. REZOLUTA 1244 E KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA

Në hartimin e Kornizës Kushtetuese, UNMIK-u u bazua tek RKSOKB 1244, sipas së cilës Kosova aktualisht është një protektorat ndërkombëtar administruar nga UNMIK-u. Kjo rezolutë e detyron OKB në Kosovë të “mundësojë një administratë të përkohshme” e cila do t’i ofrojë Kosovës “autonomi thelbësore” në kuadër të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Po kështu, rezoluta e ngarkon OKB-në me detyrën e “krijimit dhe mbikqyrjes së zhvillimit të institucioneve vetëqeverisëse demokratike të përkohshme”.³ Në vijim të krijimit të administratës së UNMIK-ut, përgjegjësitë e përcaktuara për të nga RKSOKB 1244 përfshijnë një proces prej katër fazash për krijimin e institucioneve vetëqeverisëse dhe zgjidhjen e statusit përfundimtar të Kosovës. Këto faza janë⁴:

Faza 1 – “Organizimi dhe mbikqyrja e zhvillimit të institucioneve të përkohshme për vetëqeverisje demokratike dhe autonome deri në një zgjidhje politike, përfshi mbajtjen e zgjedhjeve”;

Faza 2 – “Me krijimin e këtyre institucioneve, transferimi i përgjegjësisë administrative e njëkohësisht mbikqyrja dhe përkrahja e konsolidimit të institucioneve vendore të përkohshme të Kosovës si dhe e aktiviteteve të tjerë paqevënëse”;

Faza 3 – “Krijimi i kushteve për një proces politik me synim përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, duke pasur parasysh marrëveshjen e Rambujesë”;

Faza 4 – “Në një fazë përfundimtare, mbikqyrja dhe transferimi i autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës tek institucionet e themeluara, me vendim politik”

Krijimi i institucioneve vetëqeverisëse dhe zgjedhjet janë konceptuar si përmbushje e dy fazave të para. Për t’u vënë re është fakti se zbatimi i fazave 3 dhe 4 që lidhet me statusin përfundimtar të Kosovës, nuk ndikohet nga zgjedhjet. Megjithë garancinë dhënë nga zyrtarët e UNMIK-ut në lidhje me këtë⁵, udhëheqësit e të dy bashkësive etnike më të mëdha, vazhdimisht kanë

shprehur shpresën ose frikën se zgjedhjet do të ishin një hap drejt krijimit të një Kosove të pavarur⁶. Serbët tremben se Kuvendi i ri me shumicë shqiptare do të synojë pavarësinë. Rrjedhimisht, shumë serbë kanë argumentuar se ata nuk duhet t'u japin legjitimitet institucioneve të reja duke marrë pjesë në votim. Nga ana tjetër, shqiptarët nganjëherë ankohen për të kundërtën, se duke krijuar institucione pa konsoliduar pavarësinë e Kosovës, bashkësia ndërkombëtare po përgatit rikrijimin e pushtetit serb në provincë në një shkallë të caktuar.

Megjithatë, në bazë të masave të RKSOKB 1244 del qartë se krijimi i institucioneve vetëqeverisëse të Kosovës nuk përbën një vendim përfundimtar për statusin e Kosovës, dhe Kuvendi nuk ka autoritet për të marrë vendime në lidhje me këtë çështje. Siç u përmend më lart, faza 3 e procesit të përcaktimit të së ardhmes të Kosovës parasheh se në vendimin për statusin e Kosovës do të merret parasysh marrëveshja e Rambujesë. Kjo marrëveshje e rendit popullin e Kosovës vetëm si njërin prej faktorëve që do të merren parasysh në përcaktimin e vendimit përfundimtar. Kështu që kërkesa e politikanëve shqiptarë që bota të marrë parasysh vetëm vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës në lidhje me pavarësinë, nuk gjen mbështetje në Rezolutën e OKB-së.

B. KORNIZA KUSHTETUESE

E nënshkruar në 15 maj 2001 nga PSSP, Hans Kaekkerup, në një ceremoni publike, Korniza Kushtetuese ishte rezultat i një periudhe dy mujore këshillimesh⁸. Në këto këshillime u përfshi një Grup i Përbashkët Pune (GPP) i përbërë nga udhëheqësit politikë dhe përfaqësues juridikë shqiptarë, përfaqësues nga UNMIK-u dhe juristë nga shtabi qendror i OKB-së në Nju Jork. Përfaqësuesit kosovarë serbë morën pjesë vetëm në ditën e parë dhe të fundit, duke parashtruar në të dyja rastet kërkesa të paralizueshme.

I përbërë nga një preambulë dhe nga 14 kapituj, dokumenti përfundimtar është më i gjatë nga sa u mendua të ishte nga zyrtarët ndërkombëtarë. Gjatësia e dokumentit dhe shkalla e hollësive pasqyrojnë këmbënguljen e përfaqësuesve shqiptarë për të siguruar kompetenca maksimale për institucionet e reja. Kjo pasqyron edhe dëshirën e tyre për të pasur një Kornizë Kushtetuese që do ta bënte Kosovën të ishte sa më e ngjashme me një shtet të pavarur. Hartuesit ndërkombëtarë arsyetojnë se dokumenti përfundimtar u jep institucioneve autoritetin maksimal të lejuar nga RKSOKB 1244.

Një çështje veçanërisht e diskutuar ka qenë emërtimi i dokumentit. Fillimisht PSSP propozoi që ajo të quhej “kornizë ligjore”. Shqiptarët e Kosovës e kundërshtuan menjëherë duke arsyetuar se meqënëse Kosova e kishte pasur një kushtetutë të sajën bazuar në ish-kushtetutën jugosllave të 1974-ës⁹, çdo kufizim i këtij statusi të mëparshëm do të përbënte një hap prapa. Përsëri, rëndësia e kësaj çështjeje buron nga dëshira e shqiptarëve të Kosovës për t'i siguruar Kosovës pushtet sa më të ngjashëm me atë të një shteti të pavarur.

Megjithatë, përfaqësuesit ndërkombëtarë mendonin se të miratoje një kushtetutë mund të kuptohej si paragjykim i statusit përfundimtar të Kosovës. Përfundimisht, emërtimi i dokumentit “Kornizë Kushtetuese” u gjykua si kompromis i pranueshëm.

Preambula konfirmon mandatin e RKSOKB 1244, me ndryshimin e vetëm se ajo i referohet “një vetëqeverisjeje në nivel të lartë në Kosovë deri në përcaktimin e statusit përfundimtar” dhe jo “një qeverisjeje të mirëfilltë(thelbësore)”. Më pas ajo përcakton se “Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes nuk do të ndikojnë apo zvogëlojnë autoritetin vendimmarrës të PSSP për zbatimin e RKSOKB 1244”. Duke pasur parasysh një numër të madh kompetencash të ndryshme që i caktohen PSSP, natyrisht¹⁰ që Komisioni Ndërkombëtar i Pavarur për Kosovën do të arrinte në përfundimin se Korniza Kushtetuese në të vërtetë ofron vetëm një autonomi të kufizuar dhe jo “një vetëqeverisjeje të mirëfilltë” siç parasheh RKSOKB 1244.

Institucionet e reja të themeluara nga Korniza Kushtetuese janë të “mirëfillta” në kuptimin se hapësira e kompetencave të tyre është e gjerë. Megjithatë, PSSP ka në të vërtetë të drejtën e pakufizuar të jetë mbi këto kompetenca. Në thelb, dhe pavarësisht nga këshillimet paraprake me faktorët vendorë, Korniza Kushtetuese është një rregullore e UNMIK-ut që mund të modifikohet në varësi të tekave të PSSP. Në të vërtetë PSSP mbetet një “tiran i ligshëm” dashamirës (sipas kuptimit klasik grek: një despot i liruar nga kontrolli dhe detyrimet). Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës kërkuar që Korniza Kushtetuese të ofronte mundësinë e një gjykatë kushtetuese e cila të mund të vepronte si kontrolluese e PSSP. UNMIK-u arsyetoi se duke qënë se Kosova është në pritje të një statusi përfundimtar dhe nuk mund të ketë kushtetutë, dhe meqënëse ndërkohë PSSP¹¹ gëzon autoritet të plotë ekzekutiv dhe legjislativ në përputhje me RKSOKB 1244, nuk mund të ekzistojë një gjykatë kushtetuese.

Përfaqësuesit shqiptarë të Kosovës kërkuar t'i shtohet Kornizës Kushtetuese një klauzolë që do të lejonte mbajtjen e referendumit për pavarësi. Megjithatë, PSSP ishte i palëkundur në atë se sipas RKSOKB 1244 Korniza Kushtetuese nuk duhet ta paragjykonte statusin përfundimtar përmes kësaj mënyre. Në të vërtetë, duke pasur parasysh rendin e ecurisë së mëtejshme të procesit politik të Kosovës parashtruar në seksionet e mëposhtme, RKSOKB 1244 vërtetë përcakton se statusi përfundimtar do të vendoset në një fazë të mëvonshme gjatë mandatit të UNMIK-ut, pas krijimit të institucioneve të përkohshme. Në RKSOKB 1244 thuhet se marrëveshja e Rambujesë do të merret parasysh në përcaktimin e statusit përfundimtar, dhe Rambujeja e ka përcaktuar “vullnetin e popullit” si një nga faktorët që do të merren parasysh¹². UNMIK-u, megjithatë, gjykoj se përmendja haptazi e referendumit në Kornizën Kushtetuese do të ishte e parakohëshme në ato momente. Sidoqoftë, Korniza Kushtetuese, në preambulën e saj e përsërit adresimin e bërë në Rambuje ndaj “vullnetit të popullit” si një nga faktorët që do të merren parasysh në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës.

C. INSTITUCIONET E VETËQEVERISJES SË PËRKOSSHME

Korniza Kushtetuese përcakton katër institucione kryesore për Vetëqeverisjen e Përkohshme: Kuvendin, Presidentin, Qeverinë dhe Sistemin Gjyqësor, si dhe një numër organizmash dhe institucionesh¹³, si dhe përcakton fushën e përgjegjësisë të tyre.

1. Kuvendi

Nga 120 vende të Kuvendit, 100 ndahen mes partive dhe koalicioneve në bazë të sistemit të përfaqësimit proporcional, duke e konsideruar krejt Kosovën si një njësi të vetme elektorale. Përveç kësaj, dhjetë vende u janë rezervuar përfaqësuesve të pakicës serbe dhe dhjetë vende të tjera pakicave të tjera¹⁴. Për të pasur të drejtën për t'u zgjedhur për këto vende, partitë apo koalicionet duhet të deklarojnë se janë përfaqësues të pakicës në fjalë. Në këtë mënyrë Korniza Kushtetuese favorizon serbët e Kosovës dhe pakicat e tjera, duke u dhënë atyre një shtesë prej dhjetë vendësh përveç atyre të fituara nga 100 vendet që ndahen mes të gjitha partive. Pra, sistemi anon në të mirë të serbëve dhe pakicave të tjera, të cilët, në Kuvend, do të kenë mundësi të ushtrojnë një ndikim jo të përpjesshëm.

Gjatë hartimit të sistemit zgjedhor, rëndësi e veçantë iu kushtua thjeshtësisë¹⁵, kështu që u vendos përcaktimi i një zone të vetme zgjedhore. Të tri partitë e mëdha shqiptare shprehën parapëlqimin e tyre për një sistem me shumë zona zgjedhore, ku çdo anëtar i Kuvendit do të mund të përfaqësonte një zonë të caktuar.

Misioni i OSBE-së arsyetoi se duke pasur parasysh mungesën e të dhënave aktuale të numrit të popullsisë, një sistem i tillë do të ishte i pazbatueshëm. Po kështu u refuzua edhe propozimi për një sistem miks bazuar në njërin anë në 30 komunat aktuale të Kosovës dhe në anën tjetër në një listë që do të përfshinte krejt provincën. Për të mos i vonuar zgjedhjet, partitë shqiptare pranuan sistemin e preferuar nga OSBE-ja.

Disa vëzhgues e shohin si përparësi këtë sistem sepse ai kufizon mundësitë për copëtimin në çifligje rajonale. Ky sistem, gjithashtu, e vështirëson mbizotërimin e Kuvendit nga një parti, duke i kthyer negociatat për ndarjen e pushtetit në një tipar të politikës kosovare. Për të siguruar shumicën në Kuvend, partitë kryesore duhet të fitojnë 61 vende nga 100, duke pasur parasysh rezervimin e vendeve të pakicave.

Veçori të tjera të diskutueshme të sistemit zgjedhor ishin dhe listat e mbyllura të kandidatëve (që do të thotë se renditja e kandidatëve në listë nuk mund të ndryshohet nga votuesit) në përputhje me Kornizën Kushtetuese¹⁶, si dhe raporti mes sekseve. Sipas parapëlqimit të udhëheqësve politikë kosovarë, në zgjedhjet vendore, në tetor 2000, u zbatuan listat e hapura të kandidatëve, çka u mundësoi votuesve ta ndryshonin renditjen e kandidatëve, gjë që solli eliminimin e shumë kandidateve femra. Në zgjedhjet e 17 nëntorit, partive u kërkohet të caktonin një femër në çdo tre kandidatë në dy të tretat e para të listave të tyre.

Sipas sistemit të listave të mbyllura, meqënëse rendi nuk mund të ndryshohet dhe meqënëse UNMIK-u pranoi që kur një femër jep dorëheqje nga Kuvendi ajo të zëvendësohet nga një femër tjetër, parashihet që Kuvendi në 25% të tij të përbëhet nga femra. Të gjitha partitë e mëdha u ankuan se votimi me lista të mbyllura nëpërkëmbte të drejtat demokratike. Gjithashtu edhe për kuotën e femrave pati ankesa se zyrtarët ndërkombëtarë po detyronin zbatimin e standarteve që nuk zbatohen as në demokracitë përfundimtare dhe për të cilat Kosova është ende e papërgatitur.

Korniza Kushtetuese e përshkruan Kuvendin si “ institucionin më të lartë legjislativ dhe përfaqësues të vetëqeverisjes së përkohshme të Kosovës”¹⁷. Funkcionet e tij janë miratimi i ligjeve dhe rezolutave, miratimi apo refuzimi i kryeministrit dhe qeverisë dhe krijimi i komisioneve për mbikqyrjen e legjislativitetit. Kuvendi ka autoritetin e miratimit të ligjeve në fushat e përgjegjësisë dhënë institucioneve të përkohshme¹⁸. Megjithatë, ashtu si u përmend, Korniza Kushtetuese përcakton qartë se të drejtat e PSSP bazuar në RKSOKB 1244 nuk shfuqizohen me krijimin e institucioneve të reja, kështu që në fakt Kuvendi ka autoritet shumë të kufizuar.

Mënyra sesi do të funksionojë Kuvendi në praktikë, do të varet nga faktorë të ndryshëm. PSSP mund t'u lejojë institucioneve të reja të qeverisin brenda parametrave të përcaktuar në Kornizën Kushtetuese¹⁹. Deri tani, zyrtarët e UNMIK-ut kanë treguar shpesh prirjen për mosbesim deri në pakënaqësi ndaj aftësisë apo përshtatshmërisë të udhëheqësve kosovarë për të drejtuar punët e tyre. Pas zgjedhjeve të tetorit 2000, zyrtarët ndërkombëtarë vazhduan të jenë autoritetet e vërteta në nivelin vendor.

Nëse pamja do të jetë e ndryshme në nivelin qendror do të varet pjesërisht nga ajo nëse kosovarët e zgjedhur do të tregojnë se mund të qeverisin me sukses, dhe pjesërisht nga qëndrimi që do të mbajë PSSP. Pavarësisht nga deklarimi i Haekkerupit se ai do t'i lejojë institucionet e reja të qeverisin në fushat që do t'u caktohen, veçanërisht konfliktuale mund të jenë ato momente kur është në pyetje financimi nga donatorë të huaj. Donatorët mund të mos jenë të përgatitur të shohin udhëheqësit vendorë tek vendosin si t'i përdorin paratë e tyre.

Po kështu shumë do të ndikojë edhe mënyra sesi partitë politike do ta përdorin Kuvendin – nëse udhëheqësit kosovarë do të përipiqen të venë në provë autoritetin që u është dhënë nga Korniza Kushtetuese, dhe nëse, e sesi, orvaten të çojnë mëtej çështjen e pavarësisë së Kosovës përmes Kuvendit. Natyrisht që nuk është realiste të mendohet se partitë shqiptare të Kosovës do t'i venë veshin ngulmimit të ndërkombëtarëve dhe do ta braktisin çështjen e pavarësisë për t'u përqëndruar në funksionimin

e institucioneve të reja. Ka pasur hamendje se partitë mund të shpallin pavarësinë apo mund të paraqesin në Kuvend një referendum për shpalljen e pavarësisë. Një mundësi e tillë nuk mund të përjashtohet. Megjithatë, ndonëse pavarësia është synimi kryesor i çdo partie shqiptare të Kosovës, duket se partitë janë të vetëdijshme se një veprim i tillë tejet konfliktual do të ishte i dëmshëm për momentin²⁰.

Sidoqoftë, ka pak gjasa që partitë shqiptare të Kosovës të luajnë me bindje lojën politike sipas rregullave të UNMIK-ut. Ekzistenca e një Kuvendi të zgjedhur me mandat demokratik do ta ndryshojë në mënyrë të pazbrapsëshme mjedisin politik në Kosovë. Çfarëdo kufizimi zyrtar të përcaktojë Korniza Kushtetuese, Kuvendi do të jetë një forum i fuqishëm përmes së cilit udhëheqësit kosovarë do të mund të mbrojnë kauzën e tyre. Pritet që marrëdhëniet me UNMIK-un të jenë më të tendosura.

2. Qeveria

Roli i qeverisë, sipas përcaktimit në Kornizën Kushtetuese, është të ushtrojë autoritetin ekzekutiv dhe të zbatojë “ligjet e Kuvendit dhe ligjet e tjera brenda përgjegjësisë të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse”. Ajo mund t’i propozojë projekt-ligje Kuvendit me iniciativën e saj. Kryeministri do të propozohet nga presidenti në këshillim me partitë politike. Parashikohet përfshirja e të paktën dy përfaqësuesve të pakicave si ministra të qeverisë.

Sipas Kornizës Kushtetuese, përgjegjësitë e qeverisë do të përfshijnë këto fusha: politikën ekonomike dhe financiare, çështjet fiskale dhe buxhetore, tregëtinë dhe industrinë, arsimin dhe kulturën, shkencën dhe teknologjinë, shëndetin, mjedisin, punën dhe mirëqënien shoqërore, bujqësinë, dhe turizmin²¹. Qeveria e re do të ketë një buxhet vjetor prej 400 milion DEM²².

PSSP i rezervohen fusha të rëndësishme kompetencash. Mes të tjerash, PSSP mund ta shpërndajë Kuvendin nëse institucionet e përkohshme “veprojnë në kundërshtim me RKSOKB 1244, apo në ushtrim të përgjegjësisë të PSSP bazuar në Rezolutë”. Ai ka “autoritetin përfundimtar për të caktuar parametrat financiarë dhe strategjikë për, dhe të miratojë, buxhetin e konsoliduar të Kosovës”. Ai ushtron autoritetin përfundimtar në emërimin dhe largimin e gjykatësve dhe prokurorëve. Ai është përgjegjës për marrëdhëniet me jashtë, por duhet të këshillohet me institucionet e përkohshme në lidhje me këtë. Ai ka autoritet të administrojë pronën publike, shtetërore dhe shoqërore dhe të caktojë rregulla për ndërmarrjet me pronësi publike dhe shoqërore²³.

Për sundimin e ligjit dhe rendit, funksionon Shërbimi Policor i Kosovës nën autoritetin e PSSP dhe nën mbikqyrjen e policisë së UNMIK-ut. Trupat Mbrojtëse të Kosovës, një organizatë e emergjencave civile që u themelua si strehë për ish-anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), dhe të cilën shumë shqiptarë duan ta shohin të zhvillohet në një ushtri të mirëfilltë, është nën kontrollin dhe autoritetin e PSSP-së²⁵. Për sundimin e sigurisë dhe mbrojtjes, Korniza ripohon mandatin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO, me të cilat PSSP duhet të bashkërendojë punën nga afër²⁶.

Pra, ndonëse Korniza i jep përgjegjësi qeverisë së sapozgjedhur në një sërë fushash, pushteti kryesor i takon PSSP-së. Për shumë çështje kjo është e logjikshme vetëm në rrethanat aktuale. Për shkak të situatës vazhdimisht të pakënaqëshme të sigurisë brenda Kosovës dhe në kufijtë e Kosovës, dhe për shkak të nevojës së vazhdueshme për prezencë serioze të KFOR-it, do të ishte irrealë që në këtë fazë kontrolli i sigurisë së brendshme dhe të jashtme të kalonte nën kontrollin vendor.

Në përgjithësi, përfaqësuesit shqiptarë të GPP-së dëshironin të siguronin një nivel të lartë kompetencash për institucionet e përkohshme. Veçanërisht, ato do kenë dashur të sigurojnë përgjegjësi për marrëdhëniet e jashtme. Fakti që PSSP është një zyrtar ndërkombëtar i pazgjedhur, përbën një burim të përhershëm dyshimi për shqiptarët e Kosovës të cilët janë të vetëdijshëm se ai jo domosdoshmërisht i përfaqëson interesat e tyre siç do të donin ata. Megjithatë, refuzimi i një ministrie të punëve të jashtme ishte befapsues duke ditur se statusi i Kosovës nuk është vendosur ende.

3. Presidenti

Dispozita për presidentin e Kosovës ka pasur rëndësi të madhe simbolike për shqiptarët e Kosovës, ndonëse u kundërshtua nga përfaqësuesit ndërkombëtarë të GPP-së dhe nga bashkësia serbe në Kosovë. Nevoja për një figurë drejtuese, edhe pse posti është kryesisht simbolik, është tepër e rëndësishme për shqiptarët e Kosovës. Presidenti shihet si kryetar shteti në pritje, çka pohon synimin e shqiptarëve për një shtetësi të tyre.

Roli i presidentit të Kosovës, në të vërtetë do të jetë tepër simbolik. Sipas Kornizës “presidenti do të përfaqësojë bashkimin e popullit dhe do të garantojë funksionimin demokratik të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes²⁷. Presidenti do të zgjidhet indirekt nga Kuvendi dhe, në këshillim me partitë politike, do të propozojë kryeministrin.

Presidenti ka detyra në aspektin e marrëdhënieve të jashtme, në bashkërendim me PSSP²⁸. Kështu, ndonëse kjo mund të ngjallë shpresat e shqiptarëve të Kosovës për një ministri të jashtme, përgjegjësia për marrëdhëniet më jashtë i takon PSSP dhe presidenti, në të vërtetë, ka një rol ceremonial. Sidoqoftë, në analogji me Kuvendin, institucioni i presidentit mund të sigurojë legjitimitet për shumicën e shqiptarëve të Kosovës duke e tejkaluar rolin e kufizuar të përcaktuar në Kornizë. Ndërkohë që presidenti mund të mos ketë pushtet zyrtar për ta përfaqësuar Kosovën jashtë vendit, padyshim që shqiptarët e Kosovës do të synojnë të përfaqësohen në arenën ndërkombëtare, e rrjedhimisht presidenti mund të marrë rëndësi shumë më të madhe nga sa përcaktohet në Kornizën Kushtetuese.

III. PARTITË SHQIPTARE TË KOSOVËS

Ndonëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OSBE-së certifikoi 26 organizata politike (parti, koalicionë dhe iniciativa qytetare), fushata për votat e shqiptarëve u mbizotërua nga tri grupime: Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). Këto tri grupime mbizotëruan zgjedhjet komunale të tetorit 2000, zgjedhjet parlamentare, dhe do të mbizotërojnë edhe Kuvendin e ri. Serbët e Kosovës, të cilët i bojkotuan zgjedhjet komunale, do të kenë një përfaqësim të rëndësishëm në Kuvendin e ri përmes koalicionit të tyre të vetëm "Kthimi".

Sipas rezultateve të pjesëshme të shpalluar nga OSBE-ja në 19 nëntor 2001, LDK-ja fitoi rreth 46.3% të votave, PDK-ja 25.5% dhe AAK-ja 7.8%. Grupimi i vetëm serb fitoi rreth 11%. Ndonëse këto rezultate ishin të pjesëshme, Kryesuesi i Misionit të OSBE-së, Daan Everts, vlerësoi se votat mund të kuptoheshin përafërsisht si rreth 50 vende për LDK, rreth 30 vende për PDK dhe më pak se 10 për AAK. Lista e serbëve mëndohet të jetë pak mbi 10 vende plus 10 vende të të garantuara për pakicën serbe²⁹. Disa parti të vogla mund të fitojnë 1 vend pas ndarjes përfundimtare të vendeve, ndërsa 10 vende të rezervuara do të ndahen mes pakicave jo-serbe.

Mbarëvajtja e zgjedhjeve është gjykuar si përgjithësisht e suksesshme, dhe për nga efikasiteti ato shënuan një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me zgjedhjet komunale të tetorit 2000. Megjithë pasqyrimin e disa shkelejeve, Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, i udhëhequr nga Këshilli i Europës, hartoi një deklaratë paraprake, përgjithësisht pozitive. Në të theksohej se megjithë disa incidente, niveli i dhunës ishte shumë më i ulët se vitin e shkuar³⁰.

Një vërejtje e vëzhguesve lidhej me pjesëmarrjen relativisht të ulët - 64%, mjaft më e ulët krahasuar me pjesëmarrjen 78% në zgjedhjet komunale. Megjithatë, Evertsi arsyetoi se rënia e pjesëmarrjes është pjesërisht për faktin se ishin regjistruar më tepër persona se në zgjedhjet komunale, përfshi serbët, dhe se në fakt numri absolut i votuesve ishte me i lartë³¹.

Dështimi i fushatës për të ngjallur të njëjtin entuziazëm si në zgjedhjet komunale ndoshta reflekton pjesërisht vështirësinë për t'i dalluar partitë nga njëra-tjetra në çështjet thelbësore. Ndërsa të tri partitë premtojnë përkushtim ndaj një qeverisjeje të mirë e demokratike, ndaj respektimit të ligjit, ekonomisë së tregut, etj., duke qënë se asnjë prej tyre nuk ka përvojë qeverisëse, është e pamundur të vlerësohen premtimet e tyre. Në lidhje me çështjen kryesore, statusin përfundimtar të Kosovës, të trija janë të përkushtuara për pavarësi. Në një masë të madhe, parapëlqimet e votuesve bazohen në traditat apo faktorët rajonalë, si dhe në personalitetin e udhëheqësve të partive.

A. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK)

Rezultati i këtyre zgjedhjeve ishte një zhgënjim i madh për LDK, e cila fitoi 58% të votave në tetor 2000 dhe shpresonte të fitonte shumë më tepër sesa fitoi në të vërtetë. Ndonëse rënia në 46.3% është më pak dramatike kur merret parasysh se shumë serbë morën pjesë në zgjedhje duke rritur totalin e pjesëmarrjes, përsëri fakti është se përkrahja ndaj LDK-së ka rënë duke e krahasuar me partitë e tjera shqiptare të mëdha. Megjithatë, LDK-ja mbetet partia më e madhe, me diferencë të konsiderueshme nga të tjerat.

LDK-ja, me udhëheqës, Ibrahim Rugovën, gëzon popullaritet kryesisht nga të qenit lëvizja politike që udhëhoqi fushatën e rezistencës pasive ndaj regjimit serb gjatë viteve 1990. LDK-ja inicoi sistemin paralel të shkollave, spitaleve dhe shërbimeve të tjera, çka e forcoi atë rezistencë. Kjo parti ka qënë e palëkundur në përkrahjen ndaj pavarësisë, duke mbajtur njëkohësisht një qëndrim bashkëpunimi ndaj autoritetit ndërkombëtar. Pra LDK-ja ka një vend nderi në arenën politike, dhe shumica e mbështetjes vjen nga inercia e përkrahësve të saj më tepër sesa nga një parapëlqim pozitiv për të. Kjo parti ka një rrjet të organizuar degësh në gjithë Kosovën.

Shumica menduan se partia dhe udhëheqësi i saj do të zhdukeshin politikisht pas fushatës së bombardimeve të NATO-s në 1999. Gjatë bombardimeve, Rugova u filmua në një takim me ish-presidentin jugosllav Slobodan Millosheviç, dhe u akuzua nga disa si tepër paqësor. Pas bombardimeve UÇK-ja veprroi me shpejtësi për të plotësuar boshllëkun e lënë nga ikja e forcave serbe, ndërsa Rugova edhe për disa javë qëndroi jashtë vendit. Megjithatë, vetëm një pakicë e shqiptarëve të Kosovës morën pjesë aktive në UÇK. Besnikëria ndaj LDK-së dhe Rugovës u rikthye ballë zmbarsjes ndaj arrogancës së UÇK-së shfaqur në dëshirën për të kontrolluar ekonominë dhe politikën në kaosin para krijimit të UNMIK-ut. Pozicioni mbizotërues i LDK-së në zgjedhjet e tetorit 2000, e risolli atë si forcën mbizotëruese politike të Kosovës.

LDK-ja ka qënë e përgjumur nga suksesi (origjinal:ka fjetur mbi dafina) dhe humbja e përkrahjes ndaj saj nuk ka qënë befasi. Në shumë aspekte ajo përbën një forcë pasive në politikën e Kosovës, dhe shumë njerëz, madje dhe në parti, kanë akuzuar udhëheqjen e saj për vetëkënaqësi ballë sfidantëve të rinj PDK dhe AAK. Një nga kritikuesit e Rugovës është edhe Bujar Bukoshi³², ish-kryeministër tani në mërgim. Rugova kritikohet si jo energjik dhe se ka humbur lidhjet me votuesit. Megjithëse Bukoshi është i acaruar me rezultatet e partisë së tij, ai ende parapëlqen LDK-në ndaj rivalëve të saj, duke parë se ajo është më tolerante, me bazë të gjerë dhe e pacënuar nga dhuna e partive të tjera³³. Disa vëzhgues pranë partisë mendojnë se ajo do të ndahet pas zgjedhjeve. Në një rast të tillë, ka shumë mundësi që Bukoshi të luante një rol udhëheqës në ndonjë nga fraksionet e krijuara me këtë rast.

Fjalimet e udhëheqësve të LDK-së gjatë fushatës kanë theksuar historinë e partisë si përkrahëse e hershme e pavarësisë. Rugova vazhdon lobimin e kryeqyteteve europiane duke shpresuar në krijimin e përkrahjes ndërkombëtare ndaj njohjes së

pavarësisë të Kosovës. Në një miting në Klinë, Rugova shpalli pozicionin e partisë: “Siç e dini ne shpallëm pavarësinë në 1991 dhe e kemi ndërtuar shtetin tonë për mëse dhjetë vjet. Rrjedhimisht, ne kërkojmë njohjen zyrtare të pavarësisë të Kosovës nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Europian dhe bashkësia ndërkombëtare”³⁴.

Menjëherë pas zgjedhjeve, Rugova e përsëriti thirrjen për pavarësi³⁵. Ndonëse kjo u kundërshtua menjëherë nga zyrtarët perëndimorë, përsëritja e aspiratës kryesore të shqiptarëve nuk ishte aspak befasuese. Shumë e rendësishme është mënyra sesi Rugova mendon ta arrijë këtë synim. Siç tregohet edhe nga fjalimi i mësipërm i Rugovës, LDK-ja mendon se Kosova e ka bërë njëherë të qartë vendosmërinë e saj për të qënë e pavarur, duke nënkuptuar se çdo deklaratë e përsëritur nuk do të thoshte asgjë të re. Synimi i shumë prej udhëheqësve të LDK-së është të fitojnë njohjen ndërkombëtare³⁶. Ndonëse nuk ka përpjekje të parakohëshme për ta ngritur këtë çështje në Kuvend, Rugova, i cili synon të bëhet presidenti i ri i Kosovës, ka shumë gjasa t’i përkushtohet kryesisht përpjekjeve për të fituar përkrahjen diplomatike ndaj pavarësisë të Kosovës.

Në fushatën e zgjedhjeve të tetorit 2000, një numur i madh sulmesh dhe kërcënimesh ndaj zyrtarëve të LDK-së mund ta ketë rritur simpatinë për këtë parti. Në procesin parazgjedhor për votimet e nëntorit 2001, atmosfera ishte shumë më e qetë, me shumë më pak raste të dhunës³⁷. Megjithatë, gazeta pro – LDK “Bota Sot”, raportoi incidente të shumta kundër zyrtarëve të LDK-së, duke i paraqitur ato si fakte të një fushate të gjerë dhune dhe kërcënimesh³⁸. Partitë e tjera e akuzojnë “Bota Sot” dhe LDK-në për vënien e kësaj të fundit në rolin e viktimës, duke shfrytëzuar çdo incident si një sulm ndaj partisë³⁹.

Në 19 tetor 2001 në Skënderaj/Sërbica u qëllua një makinë nga një makinë tjetër. Një nga dy viktimat në këtë incident ishte një gazetar i “Bota Sot”. Rugova pohoi se incidenti ishte politik dhe fajësoi PDK-në. Megjithatë, KFOR-i deklaroi se vrasjet nuk ishin politike, por të motivuara nga gjakmarrja jo-politike⁴⁰. Krim politik ose jo, LDK-ja nxitoi të përfitojë nga rasti se edhe një herë ajo ishte viktimë e dhunës politike. PDK-ja e dënoi sulmin por në të njëjtën kohë kritikoi LDK-në për manipulim të incidentit për përfitimë politike. Megjithatë, incidente të dhunshme ka pasur, dhe AAK-ja u dënua nga Nën-komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Apelime, për shkak të kërcënimeve dhe dhunës fizike të përsëritur të një anëtari të AAK-së ndaj përkrahësve të LDK-së në Deçan/Decani⁴¹.

B. PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK)

PDK-ja mbetet partia e dytë në vend, dhe e ka ngushtuar diferencën me LDK-në. Ndërsa përqindja e votave të fituara prej saj mbetet e njëjtë, duke pasur parasysh pjesëmarrjen e serbëve, përqindja e votave të shqiptarëve që kanë votuar për PDK-në është rritur. PDK-ja udhëhiqet nga Hashim Thaçi, i cili ka përfaqësuar UÇK-në në negociatat e Rambujesë në 1999. Partia, e cila u themelua në shtator 1999, shihet si pasuesja politike e UÇK-së. Duke pasur uniformën e UÇK-së, për pak kohë u duk se, me autoritetin e udhëheqësit të luftës çlirimtare kundër Serbisë, Thaçi dhe UÇK-ja do të trashëgonin pushtetin politik në Kosovë. Me tërheqjen e trupave serbe, ish-luftëtarët e UÇK-së, jo të gjithë aleatë të Thaçit, fillimisht morën në kontroll të 26-të komunat me shumicë shqiptare të popullsisë, dhe formuan një qeveri të përkohshme. Gati në të gjitha ndërmarrjet shoqërore u emeruan menaxherë të tjerë.

Megjithatë, ajo që në fillim u duk si një fitore e madhe u kthye në një barrë çka ndikoi në humbjen e zgjedhjeve. Të rralla ishin rastet kur ish-luftëtarët e UÇK-së, kryesisht më moshë të re, kishin përvojën e nevojshme për të drejtuar komuna dhe ndërmarrje. Njerëzit me më tepër përvojë por që nuk ishin anëtarë të lëvizjes u lanë mënjanë apo u dëbuan. Marrja e kontrollit nga UÇK-ja u pa në përgjithësi si pushtim. Për pasojë, PDK-ja dhe Thaçi u panë si përgjegjës për kaosin, korrupsionin dhe kriminalitetin e periudhës menjëherë pas lufte. LDK-ja e Rugovës që qëndroi e veçuar në 1999 dhe në fillim të 2000, përfitoi nga pakënaqësia ndaj PDK-së. Zgjedhjet komunale të tetorit 2000 ishin një zhgënjim i madh për PDK-në, ndonëse shumica e bashkësisë ndërkombëtare me vështirësi e fshehu lehtësimin për humbjen e një force që ata e lidhnin me ekstremizmin, krimin e organizuar dhe dhunën. PDK-ja fitoi shumicën e përkrahjes në Drenicë, vendlindja e Thaçit, një rajon i varfër në perëndim të Prishtinës.

Prej atëherë kjo parti është përpjekur ta përmirësojë imazhin e saj dhe të rizbulojë veten si një parti e përgjegjshme së cilës mund t’i besohet pushteti politik. Me këtë synim u zgjodh si kandidatë për president Flora Brovina, veprimtare e të drejtave të njeriut, ish-e burgosur politike në Serbi, pediatre, poete dhe presidente e Lidhjes së Grave Shqiptare të Kosovës. Partia u organizua në të gjithë provincën duke shpresuar në rritjen e përkrahjes përtej zonave qendrore. Duke parë rritjen e numrit të votuesve shqiptarë, PDK-ja e ka plotësuar një synim të saj.

Për të moderuar imazhin e saj, PDK-ja është përpjekur të paraqitet si partia së cilës më së shumti mund t’i besohet për arritjen e pavarësisë. Nga tri partitë kryesore shqiptare të Kosovës, PDK-ja ishte kritikuesja më e zjarrtë e Kornizës Kushtetuese. Thaçi mendonte se vendimmarrja e vërtetë mbetet në kompetencë të PSSP. Ai shpalli mendimin e tij se “ky dokument do ta mbajë peng synimin e popullit të Kosovës, që është pavarësia politike”⁴².

Megjithatë, PDK-ja e ka pranuar realitetin politik dhe synon të veprojë brenda Kornizës. Ky vullnet për të vepruar brenda hapësirës së caktuar për partitë politike të Kosovës, megjithatë nuk mund të besohet lehtë. Nëse udhëheqja e partisë ndien se bashkësia ndërkombëtare ndërmerr veprime që anashkalojnë interesat e shqiptarëve të Kosovës, sipas përcaktimit të vetë shqiptarëve, si p.sh. marrëdhëniet e UNMIK-ut me Beogradin, bashkëpunimi i PDK-së mund të mos zgjasë për shumë kohë.

C. ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK)

Partia më e re nga të tri partitë kryesore, AAK, u themelua në maj 2000 si aleancë e gjashtë partive (më pas të mbetura katër) nën udhëheqjen e Ramush Haradinajt. Haradinaj ishte një komandant i mirënjohur i UÇK-së, dhe imazhi i tij si hero i luftës e ka bërë të gëzojë besueshmëri të lartë mes shumë shqiptarëve, sidomos në rajonin e Dukagjinit ku edhe ka vepruar gjatë konfliktit. Shfaqja e AAK-së sfidoi si LDK-në ashtu edhe PDK-në, dhe AAK-ja fitoi rreth 8% të votave në zgjedhjet komunale të tetorit 2000. Sfida e AAK-së ndaj PDK-së qëndron në faktin se PDK-ë nuk është më e vetmja parti e besueshme trashëgimtare e UÇK-së. Megjithatë, ashtu si edhe PDK-ja, AAK-ja u përpoq të tërhiqte përkrahës të LDK-së të plogështuar dhe me probleme në rritje. Rezultati i saj në zgjedhjet parlamentare ishte më i ulët nga sa shpresonte ajo vetë. Po ashtu si edhe PDK-ja, ajo fitoi të njëjtën përqindje votash por pati rritje të numrit të votuesve shqiptarë. Pra, përshtypja e përgjithshme është se si PDK-ja ashtu dhe AAK-ja kanë përparuar në dëm të LDK-së.

AAK-ja ndoshta bëri fushatën zgjedhore më të shkathët nga partitë kryesore. Me parrullën “As majtas, as djathtas, vetëm drejt” ajo u përpoq të paraqitej parti e qendrës, pra më praktike se rivalët e saj. AAK-ja kë të njëjtin qëndrim të palëkundur si dy partitë e tjera në lidhje me pavarësinë. Megjithatë, Haradinaj ka një marrëdhënie bashkëpunimi me UNMIK-un. Partia është përpjekur të distancohet nga rivalët e saj duke pohuar se përfaqëson një qeveri të punës dhe efektive. Për shembull, në një miting në Klinë, Haradinaj pohoi se “ nëse dikush ju pyet pse mendoni se AAK-ja është më e mira, do t’ju kërkoja të mos thoshit se jemi patriotë sepse të gjithë jemi patriotë dhe të gjithë e duam Kosovën. Përgjigjuni se AAK-ja punon më tepër se partitë e tjera, se anëtarët e AAK-së zgjohen më herët se anëtarët e partive të tjera dhe se ata do të bëjnë më tepër sesa të tjerët për ju. Mund të them se personalisht unë punoj më tepër se Thaçi dhe se Rugova”⁴³.

Në një përpjekje për ta zgjeruar shtrirjen e saj, AAK-ja antarësoi të shumërespektuarin ish udhëheqës komunist në Kosovë, Mahmut Bakallin. Ashtu si kandidatja për presidente e PDK-së Brovina, Bakalli këmbëngul që pavarësisht se është në listën e kandidatëve të AAK-së, ai mbetet i pavarur dhe nuk është anëtar partie. Bakalli mendon se elektorati po piqet gjithmonë e më tepër politikisht dhe se AAK-ja duhet t’i përgjigjet kësaj duke vënë theksin në çështje praktike në vend të mburrjes mbi çështjen e pavarësisë⁴⁴.

Ka një lloj dykuptimësie në lidhje me qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare ndaj Haradinajt dhe AAK-së. Tregohet respekt për qasjen profesioniste të partisë dhe organizimit të saj efektiv, dhe për energjinë e Haradinajt, si dhe vlerësohet qëndrimi i moderuar praktik dhe bashkëpunues i partisë. Në anën tjetër, janë ngritur dyshime mbi lidhjet e tij me persona të dyshuar si kriminelë dhe me elementë ekstremistë. Ashtu si Thaçi dhe PDK-ja, Haradinaj u është përshtatur rrethanave, duke qënë i vetëdijshëm se udhëheqësit e Kosovës duhet të japin prova se dinë të drejtojnë administratën, të nxisin zbatimin e ligjit, të respektojnë pakicat etj. Megjithatë duke pasur parasysh historinë e tij, ai duhet të provojë se cili është.

D. KOMBINIME TË MUNDËSHME

Kuvendi do të mbledhet në seancën e parë vetëm pas certifikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Vetëm atëherë mund të konfirmohet ndarja e saktë e vendeve. Duke pasur parasysh se asnjë parti nuk do të ketë shumicën absolute në Kuvend, do të lindë nevoja për marrëveshje mes partive. Nga shumë drejtime janë bërë thirrje për të lënë mënjane dallimet dhe për të formuar një qeveri me bazë të gjerë. AAK-ja vazhdimisht ka bërë thirrje për një front të gjerë, i cili mund të përfshinte edhe përfaqësues të partive të pakicave. Bakalli thekson rëndësinë e paraqitjes para bashkësisë ndërkombëtare në një front të vetëm të bashkuar që do të përfaqësonte aspiratat politike të shqiptarëve të Kosovës. Edhe Bukoshi shpreson se udhëheqësit politikë do të shfaqin “kurajon politike të duhur për krijimin e një fronti të përbashkët”⁴⁵.

Gjithashtu edhe Thaçi tregoi interesin e PDK-së për krijimin e një qeverie me një koalicion të gjerë⁴⁶. Menjëherë pas zgjedhjeve, pikëpyetja kryesore ka qenë përgjigja e LDK-së, ndërsa ajo mundohej të kontrollonte zhgënjimin nga rezultati⁴⁷. Rugova shpalli në mënyrë jo direkte, se rezultati do të thoshte se do të ishte “e vështirë të krijoheshin institucione efektive”, por se ata do të bënin të pamundurën “ta çonin këtë proces më tej”⁴⁸. Megjithatë, opsionet e LDK-së ishin të kufizuara. Megjithë sygjerimet e hershme se do të përpiqej të gjente përkrahje mes pakicave jo serbe, rezultatet e pjesëshme tregojnë se ata mbeten larg të qenit shumicë. Kështu që ndonjë lloj koalicioni mund të jetë rezultati më i mundshëm, ndonëse mundësitë për acarime në një qeveri të tillë janë të larta.

Teorikisht, përfaqësuesit e pakicave serbe dhe të pakicave të tjera, mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e presidentit dhe të kryeministrit. Presidenti i Kosovës do të zgjidhet nga Kuvendi me votim të fshehtë, dhe më pas presidenti do të propozojë kryeministrin dhe qeverinë të cilët do të miratohen apo refuzohen nga Kuvendi. Megjithatë, mundësia e përfaqësuesve serbë për të ushtruar një ndikim të tillë mund të mjaftojë për t’i përqëndruar mendjet e partive shqipëtare në arritjen e një marrëveshjeje mes tyre.

Ashtu siç është përmendur, partitë shqiptare në thelb dallojnë shumë pak njëra nga tjetra. Të gjitha e pranojnë se duhet të provojnë aftësitë për të qeverisur me efikasitet. Të gjithë e kuptojnë se nevojitet durim në qasjen drejt synimit përfundimtar, pavarësisë. Asnjë prej tyre nuk ka gjasa të tregojë durim pa fund nëse ata nuk shohin se bashkësia ndërkombëtare vazhdon të lëvizë në atë drejtim që ata duan të shkojnë. Pra, shumë pak mund të thuhet në këtë fazë mbi ndryshime të mundshme të qasjeve pas zgjedhjeve.

Së paku, fillimisht, partitë ka gjasa të përqëndrohen në funksionimin e institucioneve të reja, por herët ose vonë ato mund të fillojnë të venë në provë kufijtë e caktuar për këto institucione të reja. Mbi të gjitha, ato do të vëzhgojnë sjelljet e UNMIK-ut në vazhdimin e marrëdhënieve të tij me Beogradin. Aktualisht ato dyshojnë së tepërmi për qëllimet e ndërkombëtarëve, dhe nëse ky dyshim ushqehet nga veprimet e UNMIK-ut, arëherë udhëheqësit shqiptarë të Kosovës ka mundësi t'i tendosin marrëdhëniet e tyre me administratën ndërkombëtare. Në një rast të tillë, asnjë nga udhëheqësit shqiptarë nuk do të donte të dukej i plogësht në mbrojtje të interesit kombëtar.

IV. Pjesëmarrja Serbe

Mes të gjitha çështjeve të diskutueshme në procesin para zgjedhor, shumica e energjisë politike të bashkësisë ndërkombëtare u përkushtua në çështjen nëse serbët e Kosovës do të merrnin pjesë. Kjo pasqyroi mendimin e përhapur në kryeqytetet perëndimore se bojkoti serb do të përbente një dështim domethënës të përpjekjeve të UNMIK-ut për të ndërtuar një shoqëri shumëetnike në Kosovë.

Beogradi do të luante gjithmonë një rol vendimtar në përcaktimin e asaj nëse serbët e Kosovës duhet të merrnin pjesë, dhe kështu që përpjekjet e ndërkombëtarëve për të siguruar pjesëmarrjen u përqëndruan në marrjen e miratimit të Beogradit. Ndërkohë që Beogradi e zvarriste përgjigjen, përpjekjet e ndërkombëtarëve për të siguruar një marrëveshje u bënë edhe më energjike.

Preokupimi perëndimor për të siguruar pjesëmarrjen serbe ishte sa i panevojshëm aq dhe i dëmshëm. Ndërsa pjesëmarrja ishte shumë e dëshirueshme, të vetmit që do të vuanin refuzimin e saj ishin vetë serbët e Kosovës. Përshtypja se bojkoti serb do të përbente një dështim të rëndë për UNMIK-un ishte e gabuar. Pas përpjekjeve për të bindur serbët për pjesëmarrje, procesi i krijimit të institucioneve të reja dhe përparimi drejt zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës mund të ishte bërë pavarësisht nga pjesëmarrja e tyre. Përpjekjet e dëshpëruara për të siguruar një miratim nga Beogradi vetëm krijuan probleme të tjera për UNMIK-un me udhëheqësit shqiptarë të Kosovës të cilët kundërshtuan me mllef rëndësinë që i jepej rolit të Beogradit në problemet e Kosovës.

A. Çështjet e diskutuara

Udhëheqësit serbë paraqitën arsye të ndryshme se pse ata mendonin se nuk kishin plotësuar kushtet për pjesëmarrjen e serbëve. Kërkesat e sakta ndryshonin, duke reflektuar vështirësitë që ka koalicioni qeverisës i Beogradit në gjetjen e një pozicioni të përbashkët. Kërkesat kryesore përfshinin përmirësimin e sigurisë të serbëve, kthimin e refugjatëve serbë, lirinë e lëvizjes në Kosovë dhe zgjidhjen e çështjes të serbëve të zhdukur.

Në të vërtetë, situata e sigurisë për serbët dhe romët në Kosovë mbetet shumë e pakënaqëshme. Llogaritet që 170,000 serbë të Kosovës të jenë strehuar në Serbi dhe Mal të Zi pas tërheqjes së forcave jugosllave të sigurimit në 1999⁴⁹. Për shkak të dhunës dhe kërcënimeve që shumë prej tyre provuan nga hakmarrësit shqiptarë të inatosur pas një dekade abuzimesh, shtypjesh dhe përpjekjeve për genocid, serbët që mbetën në Kosovë u vendosën në enklavat e mbrojtura nga KFOR-i, apo në rajonin e kontrolluar nga serbët në veri të lumit Ibër.

Ka shenja modeste se pozicioni i serbëve në Kosovë po bëhet më i sigurt, kryesisht nga kalimi i kohës. Megjithatë rastet e vazhdueshme të dhunës dhe kërcënimeve ndaj serbëve gjatë vitit 2001 kujtojnë se Kosova mbetet një vend tepër i pasigurt për serbët. Sulmi me bombë në shkurt të 2001 mbi Nish Ekspres, një autobus që transportonte serbë në Serbi, gjatë të cilit u vranë 11 vetë, e tronditi besimin e serbëve të Kosovës⁵⁰. Përforcimi i sigurisë ndoshta ka parandaluar mizori të tjera të kësaj natyre. Megjithatë incidente të ndryshme ndëretnike ndodhën në korrik 2001, përfshi goditjen me gurë të një autobusi kosovaro-shqiptar tek kalonte përmes Graçanicës dhe „një javë më pas, goditjen me gurë të një autobusi nga Nishi në Serbinë jugore. Në janar dhe shkurt 2001 dy banorët e fundit serbë të qytetit të Podujevës, dy gra të moshuara që kishin jetuar dy vitet e fundit nën mbrojtjen e KFOR-it dhe nën kërcënime të vazhdueshme, u larguan nga qyteti duke u shoqëruar me “skena të shëmtuara fishkëllimash dhe sharjesh”⁵¹.

Ndërkohë që kushtet e sigurisë dhe lirisë të lëvizjes janë qartazi të mangëta, po kështu janë dhe kushtet për kthimin e refugjatëve. Kthimi i vetëm i rëndësishëm i organizuar në gusht 2001, ishte ai i 83 serbëve në fshatin Osojane në Kosovën veri-perëndimore. Nuk ka dyshim se pa mbrojtjen e trupave të KFOR-it, të kthyerit do të ishin në rrezik të madh. Disa punonjës humanitarë kanë shprehur kundërshtim serioze mbi projektin duke sygjeruar se UNMIK-u ka luajtur kumar me jetët e serbëve vetëm për hir të gjestit të kthimit.

Ndonëse udhëheqësit shqiptarë i kanë dënuar aktet e dhunës kundër serbëve dhe kanë shprehur përkrahje për kthimin e tyre, armiqësia antiserbe është shpesh tepër e madhe. Ka një mendim mjaft të përhapur mes zyrtarëve ndërkombëtarë së këto deklarata dënuese kanë qënë të pasinqerta dhe se në përgjithësi udhëheqësit shqiptarë kanë dështuar në përdorimin e autoritetit të tyre moral, për të kundërshtuar me forcë sulmet dhe kërcënimet kundër serbëve. Është shpresuar se kjo do të ndodhte⁵², por kontaktet e ICG-së kanë konfirmuar prirjen e udhëheqësve shqiptarë për ta lënë përgjegjësinë e serbëve në derën e UNMIK-ut dhe të vetë serbëve, duke anashkaluar përgjegjësinë e tyre⁵³.

Përveç kushteve të serbëve në Kosovë, Beogradi kërkonte garanci që kuvendi i ri nuk do të ndërmerre hapa drejt pavarësisë, dhe se statusi i Kosovës nuk do të ndryshohej⁵⁴. Në fakt, siç e thamë, Korniza Kushtetuese përjashtoi çdo iniciativë të tillë të

Kuvendit. Udhëheqësit e Beogradit mund të kenë dashur të marrin premtimin që Kosova nuk do të bëhet kurrë e pavarur, por PSSP nuk mund ta japë një premtim të tillë sepse nëse do ta jepte do të binte ndesh me RKSOKB 1244, e cila e le të hapur çështjen e statusit përfundimtar. Po kaq irrealë ishin kërkesat e Beogradit për kthimin e disa njërive të Ushtrisë Jugosllave dhe Policisë në Kosovë. Megjithëse në përputhje me rezolutën 1244, një hap i tillë do të ishte tepër destabilizues për t'u marë parasysh nga bashkësia ndërkombëtare.

Një synim i autoriteteve jugosllave mund të ketë qënë kërkesa për miratimin e ndonjë strukture zyrtare brenda së cilës Beogradi do të kishte të drejtën e fjalës mbi drejtimin e punëve në Kosovë, duke konfirmuar në mënyrë praktike sovranitetin e mëtejshëm të RFJ-së mbi Kosovën⁵⁵. Kryetari i Qendrës të Koordinimit me Kosovën të RFJ-së, Nebojsa Çoviç, gjtë një vizite në Kombet e Bshkuara në Nju Jork në shtator 2001, propozoi institucionalizimin e marrëdhënive mes Beogradit dhe UNMIK-ut⁵⁶. Që Beogradi nuk i kishte institucionalizuar lidhjet me UNMIK-un më herët pasqyrohet nga sjelljet jo bashkëpunuese të udhëheqësve të RFJ-së me UNMIK-un. Megjithatë, propozuar nga Çoviç, Beogradi mund të ketë vendosur se krijimi i lidhjeve institucionale me UNMIK-un mund të ofrojë një mundësi për rritjen e ndikimit të Beogradit në provincë. Siç e kemi përmendur, marrëveshja e arritur mes Beogradit dhe UNMIK-ut për pjesëmarrjen e serbëve në votime është kuptuar nga udhëheqësit shqipëtarë të Kosovës të paktën si një lidhje e tillë institucionale. Beogradi gjithashtu mund t'i kërkojë UNMIK-ut dhe KFOR-it të nënshkruajnë marrëveshje për statusin e misionit dhe statusin e forcave me Jugosllavinë, që zyrtarisht është vendi pritës⁵⁷.

B. BEOGRADI DHE KOSOVA

Për shumë politikanë në Beograd, kërkimi i garancive të ndryshme për sigurimin e pjesëmarrjes serbe në zgjedhjet e Kosovës mund të ketë qënë më tepër se sa një mënyrë për të maskuar paaftësinë e tyre për të pranuar humbjen e Kosovës. Ndërkohë që shumë fugura udhëheqëse serbe privatisht e pranojnë se e kanë humbur Kosovën, kjo çështje është aq delikate për publikun e gjerë sa ata e ndiejnë që vetëm mund të humbin politikisht nëse dialogojnë në mënyrë konstruktive me UNMIK-un.

Në origjinë të agonisë së gjatë të udhëheqësve të Beogradit nëse u duhej bërë thirrje për pjesëmarrje serbëve ose jo, ka qënë mungesa e dëshirës për të marrë përgjegjësi politike për një veprim që do të pranonte legjitimitetin e institucioneve të vetëqeverisjes së Kosovës. Pra ka qënë thelbësore, që përpara se udhëheqja e Beogradit t'i ftonte në pjesëmarrje serbët e Kosovës, të arrihej një konsensus brenda koalicionit qeverisës Opozita Demokratike e Serbisë (DOS). Mbi të gjitha kjo nënkuptonte që presidenti jugosllav Voislav Koshtunica-udhëheqësi i Beogradit me besueshmërinë më të lartë për çështjet kombëtare- duhet të jepte mendimin e tij për çdo vendim.

Skena e politikës së brendshme serbe mbizotërohet nga lufta politike mes Koshtunicës dhe kryeministrit serb Zoran Xhinxhiç që u rishfaq e përforcuar në gusht 2001, pas vrasjes së Momir Gavriloviç⁵⁸. Çështja e pjesëmarrjes në zgjedhjet e Kosovës u përfshi në këtë luftë më të gjerë sepse asnjë nga protagonistët nuk mund të rrezikonte të fajësohej për shitjen e interesave serbe në provincë.

Mungesa e dëshirës të Koshtunicës dhe e partisë së tij Partia Demokratike e Serbisë (DSS) për të miratuar pjesëmarrjen e serbëve mund të shpjegohet me faktorë të ndryshëm, përfshi lidhjen e vazhdueshme me projektin "Serbia e madhe". Së dyti, ishte frika se krijimi i institucioneve të reja rrezikonte zgjimin e strukturave paralele serbe në ato pjesë të Kosovës ende nën kontrollin serb, në veri të lumit Ibër ku DSS është e fortë. Së treti, udhëheqësit e DSS-së kanë pasur frikë se po ofendojnë thelbin e partisë, përbërjen nacionaliste, në të mirë të partive të tjera në skenën politike serbe.

Për Xhinxhiçin dhe për ata pranë tij në DOS, Kosova është pothuajse një çështje jo ekzistente. Rëndësia e saj qëndron kryesisht në mundësinë për ta dëmtuar atë politikisht. Pra, ndërsa qeveria serbe e njeh administratën e UNMIK-ut dhe kërkon bashkëpunim me të, Xhinxhiçi i shmang kontaktet personale me UNMIK-un, duke ia lenë këtë përgjegjësi Çoviçit dhe Koshtunicës. Duke pasur ende popullaritet të ulët Xhinxhiçi nuk dëshironte të shfaqej në lidhje me çështjen e pjesëmarrjes serbe në zgjedhjet e Kosovës. Duke i lenë vendimarrjen Koshtunicës dhe duke mos shkelur hierarkinë në lidhje me këtë çështje, Xhinxhiçi mund të maskohet politisht.

C. MARRËVESHJA

Një problem madhor në sigurimin e pjesëmarrjes të serbëve të Kosovës në zgjedhje ishte arritja e një pozicioni të përbashkët në udhëheqjen e Beogradit çka shmangte përgjegjësinë personale. Në 23 tetor 2001, në një mbledhje të përfaqësuesve të qeverive federale dhe serbe, Beogradi nxorri një shpallje në lidhje me kërkesat që duhet të plotësoheshin për t'u arritur marrëveshja në lidhje me pjesëmarrjen e serbëve⁵⁹. Kjo u pasua nga një raund i fundit dhe tepër energjik i takimeve mes UNMIK-ut dhe Beogradit për të zvogëluar dallimet mes tyre. Megjithëse udhëheqësit serbë ndërkohë mund të kishin vendosur pjesëmarrjen e serbëve përpara se Koshtunica të shpallte marrëveshjen me UNMIK-un në 3 nëntor 2001, ata u përfshinë në një lojë të jshhtëzakonshme me zjarrin përpara se të binin dakord⁶⁰. Marrëveshja u nënshkrua nga Hakerupi dhe Çoviçi në Beograd, në 5 nëntor.

Marrëveshja konfirmon me kujdes parimet e RKSOKB 1244 në lidhje me sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RFJ-së dhe se "pozicioni mbi statusin e Kosovës mbetet si ai i shpallur në rezolutën 1244", që do të thotë se çështja mbetet e hapur, megjithëse kjo nuk është shkruar haptazi në marrëveshjen e Beogradit. Dokumenti pohon se institucionet e Kosovës nuk do të kenë autoritet për të ndërmarrë hapa në lidhje me statusin përfundimtar. Pjesa më e madhe e dokumentit lidhet me nevojën për

të përmirësuar fatin e serbëve në Kosovë. Ajo gjithashtu përshëndet bashkëpunimin e krijuar së fundi mes UNMIK-ut dhe RFJ-së dhe në mënyrë jo të qartë dhe të diskutueshme pohon krijimin e një grupi pune të rangut të lartë nën PSSP, me përbërje të RFJ-së UNMIK-ut dhe institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës, pas krijimit të tyre.

Zyrtarët e UNMIK-ut dhe RFJ-së menjëherë dhanë interpretime të ndryshme për dokumentin. Zyrtarët e RFJ-së pohuan se kishin garanci se Kosova do të mbetet në RFJ dhe që marrëveshja përbënte një hap drejt kthimit të Kosovës nën juridiksionin e Beogradit⁶¹. Haekkerupi e mohoi interpretimin e Çoviçit, duke pohuar se në përputhje me rezolutën 1244 çështja e statusit përfundimtar të Kosovës mbetet e hapur dhe ndërkohë UNMIK-u kishte autoritet të plotë për Kosovën⁶².

Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës reagues me tërbim ndaj marrëveshjes. Ata kundërshtuan faktin se pse nuk ishin këshilluar apo vënë në dijeni mbi këto zhvillime. Ndërkohë që mirëpritën vendimin për pjesëmarrjen e serbëve ata u mërzhitën me atë çka shihnin si prezantim i Beogradit si faktor vendimtar në zgjidhjen e çështjeve të Kosovës. PDK dhe AAK shpallën se nuk do ta njihnin grupin e ri të punes. Haradinaj nuk mori pjesë në një takim të Këshillit Administrativ të Përkohshëm të Kosovës në 6 nëntor 2001. LDK-ja u përfaqësua nga një zyrtar relativisht pa rëndësi, ndërsa Taçi u paraqit vetëm për të thënë se marrëveshja ishte e papranueshme dhe u largua⁶³.

Në një takim elektoral në Fushë-Kosovë/Kosovo –Polje, Taçi shprehu zhgënjimin e tij në lidhje me marrëveshjen duke e lidhur këtë me pakënaqësinë e vazhdueshme me Kornizën Kushtetuese: “Ne si parti besojmë që e kemi shpallur qëndrimin tonë se nuk duam marrëdhënie të reja me Beogradin. Kjo marrëveshje përbën një dhunim të hapur të rezolutës 1244 dhe do të thotë se zbatimi i Kornizës së turpshme Kushtetuese ka filluar”⁶⁴. Në një miting në Pejë/Peç Brovina shpalli se “Demokratët e gjithë botës kanë ardhur këtu për të sjellë demokraci. Megjithatë me sjelljen tyre ata tregojnë se nuk janë demokratë. Por është e kotë, dhe, edhe nëse mund të bëjnë marrëveshje të ndryshme ata duhet ta dinë se ato nuk kanë vlerë pa nënshkrimin tonë. Ndërkombëtarët nuk ka nevojë të krijojnë pavarësinë e Kosovës. Pavarësinë do ta themelojmë ne”⁶⁵.

Inati i shqiptarëve pasqyron dyshimin në rritje ndaj bashkësisë ndërkombëtare. Mes analistëve dhe udhëheqësve po përforcohet besimi se përfaqësia ndërkombëtare po mbaron së qeni një aleat dhe është duke u bërë gjithmonë e më tepër një pengesë drejt aspiratave të tyre. Çdo përpjekje e mëtejshme e PSSP për të përfaqësuar interesat e Kosovës jashtë vendit, sidomos në Beograd, pa këshillime apo në kundërshtim me idetë e shqiptarëve për interesat e tyre, ka mundësi të çojë në një keqësim të menjëhershëm të marrëdhënieve mes UNMIK-ut dhe partive shqiptare.

D. SERBËT E KOSOVËS

Udhëheqësit serbë të Kosovës reagues në mënyra të ndryshme ndaj thirrjes së Beogradit për të marrë pjesë në zgjedhje. Pavarësisht nga shqetësimet e përbashkëta, serbët në enklavat e Kosovës dhe në veri të Ibrit në asnjë mënyrë nuk përbëjnë një trup koherent. Ata në enklavat e izoluar në Kosovë ndihen më të prekshëm përballë dhunës shqiptare dhe formave të tjera të presionit, dhe përgjithësisht janë më të motivuar të gjejnë një modus vivendi (mënyrë jetese) me shqiptarët e Kosovës. Kjo e kombinuar me një nevojë për ta zgjatur mirkuptimin e bashkësisë ndërkombëtare, ka qënë arsyeja e përkrahjes të pjesëmarrjes serbe mes udhëheqësve të moderuar serbë si Rada Trajkoviç dhe Dhespoti Artemi të vendosur në enklavën e Graçanicës pranë Prishtinës.

Në veri të Ibrit ndonëse KFOR-i dhe policia e UNMIK-ut patrollojnë, autoriteti i UNMIK-ut nuk funksionon. Ndonëse një numër i vogël shqiptarësh është ende në veri, të tjerët frenohen për të kaluar Ibrin nga rojet serbe të njohura si “rojet e urës”. Serbët e veriut të Kosovës përbëjnë një bllok etnik relativisht kompakt që është në kufi me Serbinë dhe për këtë ndjehen më të sigurt. Për ata, kontrolli i Beogradit mbetet real. Nga ky këndvështrim, bashkëpunimi me UNMIK-un shihet si humbje e lidhjeve me Beogradin dhe afirim me Prishtinën. Një aktor i rëndësishëm politik në veri të Mitrovicës është Marko Jaksiç, zëvendëspresident i partisë së Koshtunicës, i cili gjithmonë ka ndjekur vijën e ashpër në lidhje me pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës. Një tjetër udhëheqës i vijës së ashpër është kryetari i lëvizjes serbe të rezistencës (SPOT), Momçillo Trajkoviç. Serbët e Kosovës do të përfaqësohen nga një listë e vetme shumëpartiake, koalicioni “kthimi”, i cili përbëhet nga të gjitha partitë kryesore të DOS-it. Udhëheqësit e moderuar serbë të Kosovës si Rada Trajkoviç dhe Dhespoti Artemi e mirëpritën rekomandimin e Beogradit për të dalë në votime. Atyre iu bashkua dhe Patriarku Pavle i Kishës Ortodokse, i cili ka banuar në Kosovë për shumë vite⁶⁶. Megjithatë, Jaksiç dhe Trajkoviç si dhe udhëheqësit vendorë të partisë demokratike të Xhinxhiçit, e dënuan marrëveshjen dhe u shprehën se serbët nuk duhet të marrin pjesë. Në vijim të presionit nga Beogradi, kundërshtimi i tyre ra në heshtje. Megjithatë, pavarësisht nga premtimet se nuk do të bënin fushatë kundër pjesëmarrjes në votime, pati shumë përpjekje të organizuara për të ndërprerë orvatjet e koalicionit “Kthimi” për të nxitur pjesëmarrjen.

V. PËRFUNDIME

Me përcaktimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve dhe formimit të institucioneve të reja, sfida kryesore për udhëheqësit politikë të Kosovës do të jetë funksionimi i institucioneve të reja për të treguar se ata mund të qeverisin me përgjegjësi dhe se me kalimin e kohës mund t’u besohen përgjegjësi të mëtejshme. Një pikëpyetje tjetër është se deri në çfarë mase do të ndërhyjë UNMIK-u në funksionimin e institucioneve të reja. Nëse dora e rëndë e PSSP do të ndihet shumë shpesh, politikanët e Kosovës nuk do të mund të ndërtojnë ndienjën e përgjegjësisë që vjen vetëm nga pushteti real. Një qasje e mençur për PSSP do të ishte t’i lejonte udhëheqësit e rinj të Kosovës të bënin gabime, të mësonin prej tyre e kështu të aftësoheshin për rolin e tyre të ri.

Megjithë themelimin e institucioneve të përcaktuara në Kornizën Kushtetuese, shqiptarët nuk do të kënaqeshin duke pritur. Megjithëse është e kuptueshme se duhet të kryhet procesi i themelimit të institucioneve dhe përgatitja për pavarësinë, shqiptarët shpresojnë të shohin përparime të mëtejshme në rrugën drejt këtij synimi. Nëse ky synim nuk realizohet durimi i tyre mund të jetë tepër i kufizuar dhe marrëdhënia mes partive shqiptare të Kosovës dhe UNMIK-ut mund të acarohet gjithnjë e më tepër. Nëse ndodh kjo, Kuvendi i sapo zgjedhur, pavarësisht nga kufizimet e tij, mund të kthehet në një forum të fuqishëm ku shqiptarët e Kosovës mund të shtrojnë për zgjidhje problemin e tyre. Në anën, tjetër, nëse mërzitë shqiptare lejohen të përparojnë, kufizimet mbi institucionet mund t'i nxisin disa të dalin prej tyre dhe të kthehen në rezistencën pasive ose ndoshta aktive, me të cilën shqiptarët e Kosovës janë shumë të familiarizuar.

Do të ishte tërësisht irrealë të shpresohet se shqiptarët e Kosovës do braktisin aspiratat e tyre për liri. Megjithatë, aktualisht institucionet e reja duhet të përqëndrohen në qeverisjen efektive. Kjo do të ishte prova më e mirë për skeptikët perëndimorë. Udhëheqësit shqiptarë kosovarë duhet të shmangin veprime të kota për pavarësi, si për shembull shpalljen e saj nga Kuvendi, çka vetëm do të nervozonte bashkësinë ndërkombëtare dhe do të ashpërsonte kundërshtimin ndërkombëtar ndaj pavarësisë.

Për më tepër, partitë shqiptare duhet të qasen në mënyrë konstruktive ndaj çështjes së pavarësisë. Ndoshta një mënyrë do të ishte krijimi i një komisioni, ndoshta në kuadrin e Kuvendit, i cili do të hartonte opsione për marrëdhëniet e Kosovës me Beogradin, do të përgatiste propozime që mund të krijojnë bazën e diskutimeve me Beogradin dhe me bashkësinë ndërkombëtare. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta nxisë një qasje të tillë konstruktive.

Ndërsa mbajtja e zgjedhjeve dhe krijimi i institucioneve vetëqeverisëse përfaqëson një sukses të konsiderueshëm për UNMIK-un dhe një hap të rëndësishëm drejt zgjidhjes së statusit përfundimtar të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare nuk mund të mjaftohet me kaq. Ky është hapi i parë dhe nuk duhet të ketë një pushim të gjatë. Shqiptarët dhe serbët e Kosovës kanë nevojë të qartësohen për rezultatin përfundimtar, nëse synohet që ata të mos e shohin njëri tjetrin si kërcënim, por të rifillojnë jetën normale së bashku. Serbia nuk ka mundësi të ndërtojë një demokraci të shëndetëshme pa u zgjidhur çështja e Kosovës. Bashkësia ndërkombëtare duhet të fillojë që në fazën e hershme të mendojë për hapin tjetër drejt dhënies fund të pasigurisë dhe shndërrimit të Kosovës nga një faktor destabilizimi në rajon në një faktor stabiliteti.

Prishtinë/Bruksel 21 nëntor 2001